



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legj. -III-

**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM
HAPËSINOR**

Procesverbal **Nr. 16**

nga mbledhja e mbajtur më **2.7.2008**

kryesuar nga **Lulzim Zeneli**-kryetar i komisionit

Mbledhja filloi në orën 13,00

Të pranishëm :

Lulzim Zeneli, Berat Luzha, Hestet Cakolli , Selvie Halimi, Kosara Nikolić, Elheme Hetemi, Zef Morina, , Ali Lajçi, dhe Myrvete Pantina..

Munguan :

Ibrahim Selmanaj, Zylfi Merxha.

Nga Sekretaria e Kuvendit : Bajram Badivuku, Drita Çarkaxhiu.

Pjesëmarrësit tjerë : Nga MBPZHR Isuf Cikaqi, Adem Arifaj, Dukagjin Zeka
Përfaqësuesi i OSCE Blerim Vela
Përfaqësuesi i presidencës Nexhat Shatri dhe vëzhgues tjerë të rregullt.

RENDI I DITËS :

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit të produkteve për Mbrojtjen e Bimëve,**
- 3. Të ndryshme.**

1. Procesverbali nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi Lulzim Zeneli hapi mbledhjen dhe u konstatua i miratuar procesverbali nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i Projektligjit të produkteve për Mbrojtjen e Bimëve

Kryesuesi tha se në mbledhjen e fundit komisioni është akorduar për të përmirësuar disa nene nga zyrarët e MBPZHR siç janë :

3.1 – fjalia e parë

3.3 – një riformulim më i mirë të bëhet

23.2 – riformulim

27.1 – fjalia e fundit “Në raste të tilla.....” të përmirësohet.,

55.2 – a duhet të figuroi ky paragraf, si dhe tregtuesi duhet të dallohet nga përdoruesi.

Elheme Hetemi vërejti se në versionin zyrtar tek neni 2 mungon teksti në fillim “**Produktet për mbrojtjen e bimëve** PMB nënkupton format e përgatitura përfundimtare të substancave aktive dhe preparateve të cilat përdoren për:

1. mbrojtjen e bimëve apo prodhimeve bimore nga organizmat e dëmshëm ose”.

(**Vërejtje nga stafi** : Stafi vërtetoi saktësinë e intervenimit të deputetes në fjalë, sepse teksti në fjalë ekziston në versionin kompjuterik, ndërkaq në versionin e dorëzuar në postë nuk ekziston, ndaj nuk ka nevojë për amendament. Për këtë është njoftuar edhe Shefi i divizionit.).

Vërejtjet përfundimtare të komisionit lidhur me këtë projektligj janë si vijon :

Amendamenti 1

Preambula dhe neni 59 të harmonizohen në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Amendamenti 2

Titulli i projektligjit të përdoret njësoj në tërë tekstin e projektligjit (Gjatë spastrimit të ligjit).

Amendamenti 3

Neni 23, paragrafi 2, në reshtin e dytë fshihet “se dy”.

Amendamenti 4

Neni 27, paragrafi 1, në fund të këtij paragrafi fjalia “Në raste të tilla testet dhe analizat nuk duhet bërë brenda territorit të Kosovës” , fshihet.

Amendamenti 5

Neni 55, paragrafi 2 dhe 3 riformulohen si vijon :

(2) Me gjobë prej **2.000 €** deri **5.000 €** për kundërvajtje dënohet personi fizik nëse:

2.1 vendos në treg PMB me afat të skaduar dhe që është në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 3 të këtij Ligji,

2.2 vepron në kundërshtim me nenin 28 të këtij Ligji,

2.3 nuk përmbush kushtet për përdorim dhe aplikim të PMB sipas nenit 41 paragrafi 1 të këtij Ligji,

2.4 nëse pengon inspektimin sipas nenit 51 pika 1.9, 1.10, 1.12, të këtij Ligji.

(3) Me gjobë prej **10.000 €** deri **30.000 €** për kundërvajtje dënohet personi juridik nëse:

3.1 vendos në treg PMB me afat të skaduar dhe që është në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 3 të këtij Ligji,

3.2 vepron në kundërshtim me nenin 28 të këtij Ligji,

3.3 nuk përmbush kushtet për përdorim dhe aplikim të PMB sipas nenit 41 paragrafi 1 të këtij Ligji,

3.4 nëse pengon inspektimin sipas nenit 51 pika 1.9, 1.10, 1.12, të këtij Ligji.

3.5 vendos në treg PMB të pa autorizuar nga Ministria dhe që është në kundërshtim me nenin 3 paragrafi 1 të këtij Ligji dhe

3.6 vepron në kundërshtim me nenin 42 paragrafi 3 i këtij Ligji.

Të ndryshme

Lidhur me shkresën e Ombudspersonit të Kosovës, **Lulzim Zeneli** i propozoi rekomandimin me shkrim, ndërkaq komisioni me konsensus unanim nxori :

P Ë R F U N D I M

Kryesisë së Kuvendit ti dërgohet shkresa në vijim :

Komisioni parlamentar për Bujqësi e Mjedis pas shqyrtimit të letrës së Ombudspersoni i Kosovës lidhur me dëmtimet ne Parkut Nacional Malet e Sharrit, pas dëgjimit parlamentar ku morën pjese përfaqësuesit nga Ministria e MPH-së, Kuvendit Komunal në Prizren, Ombudspersoni i Kosovës u.d., pas takimit në Kuvendin Komunal në Prizren dhe vizitës së komisionit parlamentar në Parkun nacional Malet e Sharrit dhe Fshatin Turistik “Prevalla”:

Komisioni parlamentar për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor pas analizës se bere në mbledhjen e vet të dt. 02.07.2008 nxori këtë konstatim:

Aktivitetet e zhvilluara ne parkun nacional “Malet e Sharrit” janë ne kundërshtim me Ligjin për mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Planifikimin Hapësinorë dhe Ligji për Parkun Nacional ‘Malet e Sharrit’, prandaj i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës të nxjerr këtë:

Rekomandim

1. Të ndërpriten urgjentisht të gjitha aktivitetet në zonën e parkut nacional Malet e Sharrit, veprimtaria e gurëthyesve, aktivitetet ndërtimore ne Fshatin Turistik “Prevalla” si dhe prerjet ilegale te pyjeve.
2. Qeveria e Republikës se Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të shqyrton seriozisht gjendjen e krijuar ne Parkun nacional “Malet e Sharrit” dhe te informon Kuvendin e Kosovës lidhur me demet e shkaktuara.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës (MMPH) brenda 6 muajve të hartojë planin opercional dhe te ndaj buxhet për sanimin e gjendjes në terren.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës (MMPH) ngarkohet të raportoj rregullisht lidhur për zbatimin e këtij plani, si dhe të njoftoj publikun për regjimin e mbrojtjes në Parkun Nacional Malet e Sharrit.
5. Qeveria e Republikës së Kosovës të merr vendim që në afat prej 9 muajsh të hartohet plani hapësinor te Parkut Nacional “Malet e Sharrit” dhe i njëjti ti dërgohet Kuvendit te Republikës se Kosovës për miratim.
6. Kuvendi i Republikës së Kosovës të formoj komision hetimor parlamentar lidhur me shkeljen e ligjeve në fuqi dhe të adresoi përgjegjësitë institucionale dhe ligjore.

Mbledhja përfundoi në orën 15,00.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli